



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Shtojca 5a: Struktura e pjesës narrative të raportit (gjashtë-mujor) vjetor për konsultimet e kryera publike të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit.

1. Përmbledhja ekzekutive

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) për vitin 2025 ka realizuar në masën 100% procesin e konsultimit publik. Procesi i konsultimit publik është zhvilluar për projektligjin: “Për shërbimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë”

Për konsultimin publik të këtij akti janë përdorur metodat elektronike të komunikimit, përveç publikimit në platformën online RENJKP. Gjithashtu janë zhvilluar takime konsultative të grupit të punës, dhe ekspertëve të fushës dhe palëve të interesit.

Nga monitorimi i platformës së Regjistrat Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK), vihet re se ka pasur një numër total prej 2168 vizitorësh për projektaktion e konsultuar në këtë platformë për vitin 2025.

Shumica e akteve të MEPJ janë në lëmin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe bazuar në nenin 4, të ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik” marrëveshjet ndërkombëtare përjashtohen nga ky proces.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Brenda këtij viti janë miratuar 10(dhjetë) akte.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Për vitin 2025, MEPJ ka miratuar 1 (një) akt i cili është objekt i konsultimit publik.

“Për shërbimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë”

Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

1, projektligji “Për shërbimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë”.

2.1.3. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Nga 12 projektakte, të cilat janë parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik 2025, për 5 prej tyre janë aplikuar kriteret përjashtuese. Në nenin 4, të ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik” është parashikuar lista e projektakteve që nuk i nënshtrohet procesit të konsultimit publik. Aktet e përjashtuara nuk prekin drejtpërdrejt interesin publik, rregullojnë marrëdhëniet ndërkombëtare dhe marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe, disa prej tyre prekin fushën e sigurisë.

Kriteret përjashtuese nuk janë aplikuar për asnjë akt të parashikuar në dokumentet strategjik kombëtar apo sektorial, ndërkohë nuk ka patur akte të parashikuara në PKIE.

2.1.4. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

1 (një) projektligj

2.1.5. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Krahasuar me një vit më parë, numri i projektakteve të publikuara për konsultim publik është me i vogël për shkak të natyrës së projektakteve. Për vitin 2024 janë publikuar 3 (tre) projektligje dhe për vitin 2025 1 (një) projektligj.

2.2. Metodat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Metodat e konsultimit ishin:

- Konsultimi nëpërmjet RENJKP;
- Postë elektronike zyrtare;
- Aktorë interesi;
- Ekspertë të fushës.

2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda me posten elektronike gjeneroi numrin më të madh të komenteve. Komente për konsultimin e këtij projektligji janë dërguar edhe nëpërmjet RENJKP.

2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Nuk janë organizuar konsultime paraprake, por në mbledhjet e grupit të draftimit të projektligjit “Për shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë” kanë marrë pjesë dhe 2 ekspertë të jashtëm.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Konsultimi i projektligjit “Për shërbimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë” ka zgjatur 20 ditë pune.

2.3.2. *Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?*
20 ditë pune.

2.3.3. *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*
Krahasuar me një vit më parë, kemi një gjenerim të konsiderueshëm të komenteve të ardhura nëpërmjet emailleve.

Konsultimi publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) për të gjitha aktet e publikuara gjatë vitit 2024 dhe për aktet e publikuara në 2025 u realizuan në përputhje me parashikimin ligjor, për respektimin e afatit e kohëzgjatjes prej 20 ditësh pune duke filluar nga data e publikimit.

Gjithashtu, vihet re një përmirësim i situatës nga vitet e kaluara pasi rezultoi se si në 2024 dhe në vitin 2025 janë përcjellë komente për projektaktet edhe përmes RENJK ose përmes emailit pasi projektakti është publikuar në RENJK. Situata edhe këtë vit është përmirësuar në kuadër të marrjes së kontributit dhe komenteve nga grupet e interesit, si rrjedhojë e bashkëpunimit efektiv dhe me strukturat teknike hartuese të akteve, të cilat kanë pasur më të lehtë identifikimin e grupeve të interesit të përfshira në dhënien e kontributit të tyre.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 *Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?*
2 ekspertë të jashtëm.

2.4.2 *Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)*
Ekspertë individualë

2.4.3 *Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?*
9 aktorë të rëndësishëm të fushës ishin pjesëmarrës në proceset e konsultimit.

2.4.4 *Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?*
Një shoqatë person juridik, 7 diplomatë dhe ish diplomatë, ekspertë dhe shumë qytetar nga diaspora.

2.4.5 *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*
Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur duke u përmirësuar, gjë që konstatohet nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në konsultim, rritja e angazhimit të shoqatave në procesin e dhënies së kontributit për hartimin e këtyre akteve, të cilët

për vitin 2025 kanë dërguar më së shumti me email mendimet e tyre, pas konsultimit të RENJK.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?


Për projektligjin “Për Shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë” janë mbledhur 95 (nëntëdhjetë e pesë) rekomandime dhe komente.

2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Për projektligjin “Për Shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë”

37 (tridhjetë e shtatë) u pranuan plotësisht, 13 (trembëdhjetë) pjesërisht dhe 45 (dyzet e pesë) u refuzuan.

Fig1: Pasqyra e statusit të komenteve të mbledhura.



2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Tendenca e pranimit të komenteve dhe sugjerimeve të dhëna nëpërmjet RENJK, mbetet e kënaqshme dhe sa vjen e përmirësohet, pasi pothuajse 38% e komenteve të marra janë reflektuar dhe 13 % e komenteve janë pranuar pjesërisht.

2.5.4. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Raporti i VNR nuk është ndryshuar apo përditësuar në bazë të informacionit të marrë gjatë konsultimit publik, pasi ndryshimet nuk preknin përmbajtjen e VNR, por sigurisht këto ndryshime u reflektuan në draftin e projektligjit të dërguar për bashkërendim pranë ministrive të linjës.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

1 (një)

2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Raportet u publikuan

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c).

Referuar formatit të kërkuar nga njësia përkatëse në Kryeministri, e cila është hartuar nga MEPJ argumentojmë si vijon: Indeksi Performancës për cilësinë e konsultimit publik për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme është 8 për projektaktet e publikuara (Projektligjet publikohen në sistemin e informacionit të qeverisë, është dhënë informacion i mjaftueshëm lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit; janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre,. Kurse në përqindje indeksi sasior është 100%, pasi për projektligjin e konsultuar ka dëshmi të mjaftueshme mbi përfshirjen e palëve të interesit ku janë mbledhur prova të mjaftueshme mbi reagimet e tyre, një pjesë e mirë e të cilave janë reflektuar.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Nisur nga natyra e fushës së përgjegjësisë institucionale të MEPJ, pjesa dërrmuese e projektakteve të propozuara nga MEPJ janë të natyrës diplomatike dhe për rrjedhojë nuk plotësojnë kriteret për t'iu nënshtruar procesit të konsultimit publik, në kuptim të nenit 4(b) të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, që lidhet me marrëdhëniet ndërkombëtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare dy dhe shumëpalëshe. Ndaj në vitin 2025 nuk ka patur sfida në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri.